

VENDIM
Nr.202, datë 30.6.2011

MBI VLEFISHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK ME PËRSËRITËS
“RADIO DEUTSCHE WELLE”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Sami Neza	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar
Suela Musta	anëtare
Gent Ibrahim	anëtar (në mungesë)

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit radiofonik me përsëritës “Radio Deutsche Welle”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21 dhe neni 33 pika 2 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VËREN SE:

Me vendimin nr.68, datë 16.11.2001, KKRT-ja ka licencuar subjektin juridik “Deutsche Welle” për ritransmetimin e programeve të huaja radio në “Radio Deutsche Welle”, për një periudhë prej 4 vjetësh, me zonë licencimi pjesërisht prefekturat Tiranë, Durrës, Lezhë, Fier, me nr.001/PPH licence. Me vendimet nr.424, datë 21.3.2006 dhe nr.147, datë 22.10.2010, KKRT-ja ka rinovuar licencën për subjektin radiofonik me përsëritës “Radio Deutsche Welle”.

Me shkresën e datës 23.5.2011, subjekti radiofonik me përsëritës “Radio Deutsche Welle”, ka depozituar pranë KKRT-së kërkesën si më poshtë vijon:

“... “Radio Deutsche Welle” nuk do të vazhdojë më përdorimin e frekuencës 106.0 MHz, e për rrjedhojë, licenca e lëshuar në datën 16.11.2001, nuk do të jetë më e vlefshme...”

KKRT-ja konstaton se në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 33, pika 2 “Licenca bëhet e pavlefshme kur... i licencuari heq dorë prej saj me shkrim”.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit në bazë të nenit 7 pika 21 dhe nenit 33, pika 2, të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën me nr.001/PPH për subjektin radiofonik me përsëritës “Radio Deutsche Welle”.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati